

8JH-1
S 81

AGIM SPAHIU

**Të jetosh
me ty**

VJERSHA
DHE POEMA

844-1
581

Agim Spahiu

Të jetosh
me ty



VJERSHA
DHE
POEMA

SHTËPIA BOTUËSE
•NAIM FRASHERI•

uišaqz miqA

182

Redaktor

STAVRI DAJO

neofej et
xi em

AN29317
DHE
REBWA

Recensues:

Bujar Skëndaj.

Xhevahir Spahiu

— INDEPENDENT PRESS —

Këtu

Këtu dielli rrrezon për mua dhe bora boron për
mua,
në gjakun tim shkrirë janë të gjitha viset e tua,
qysh në britmën e lindjes me tokën çift i dashuruar,
rroj në male fisnike me ujëra jetëdhënëse pranë,
në përqafimin e lumenjve të mi: njëri i bardhë,
tjetri i zi.
Këtu jam i idhët pelin, i ëmbël si misri i ri,
marr udhët me bukën në xhep, përshëndetem,
përshëndes,
në frymën tonë mirësia çel gonxhen me shpresë.
Këtu jam plot shëndet. Kam shumë punë për të
bërë
dhe s'kam nge të vdes.
Këtu dhë vetëm këtu jam guri me rrënje, i rëndë
në vend të vet.
Jam zjarr që djeg e përvëlon, dorë e butë që
e ndërton, përkëdhel
fjalë mjaltë që mrekullon.

Brenda meje përkunden djepe, shtrihen varre pa
 harrim,
klithma flake përzhitin ende malet e visit tim...
«Këtu!», më thonë djetëfish (ta dish!)
 thonë varret e gurët,
Shekspiri éshtë luajtur dhjetëfish (ta dish!)
në familje, në Qafën e Kolesjanit e të Prushit,
 në Morin
dhe brenda gjoksit të njeriut.
Jam këtu përqafuar me diellin, dragua për të mos
 harruar asgjënë,
mbrojtës, rojtar nderi i fytyrës sime që s'e çbënë...
Rris pemët, shtrydh gurin e ujin të më japid më
 tepër
dhe unë gjithçka u japid, më çdo gjë pjesëtoj veten.
Me armiqtë thikë më thikë jam këtu,
i dashuruar me të dashurit e mi. Këtu dhe vetëm
 këtu jam puthja,
mallkimi, èndrra dhe zgjimi,
dashuri më udhët e tua
ku bora e dielli rrezojnë për mua.

Katunde tē moçme veriore

Nëna tē dhembshura kruspull bri fëmisë,
fushëzën e paktë mëkonin me sisë...

Mëngjeset që vijnë unë i kam....

poemë

Unë jam dita, gëzimi, puna dhe bukuri e saj e përjetshme;
ky mëngjes, dielli që puth dheun e shkrihet tek fruti me mrekullinë e vet,
profilet e mëngjeseve që vijnë unë i kam:
në vështrimin tim, brenda gjokshit, në mendimet e partishme janë.
Jam zot i maleve qeleshebardhë, fushave, bjeshkëve,
zot i ujërave të kristaltë, lugjeve, pyjeve kurorëgjelbër,
zot i mbitokës që e lulëzoj me këto duar të mëdha,
të cara, damarëdalë, nga puna e lufta ejeta të rrahura.
Dhe zot i nëntokës jam: me bukurinë e saj të fshehur thellë;
përpinqem, e shkoq nga gjiri i tokës, e nxjerr në drithë
të heshturën, shekulloren bukuri,
në duart e mia e bëj pasuri.
Jam zot i bukurisë dhe bukuria jam vetë,

çel në grurin e lulen, në mëngjesin e pemën,
para çdo gjallese me shpresë unë e përshëndes
jetën.

Jam zot i dashurisë që rron brenda meje, në sytë,
krahët, punën e buzëqeshjen,
zot i dashurisë që frymë merr në viset e mia.
Dhe brenda meje, brenda gjoksit tim, mali i
dashurisë për ty ngrihet, Gjalicë,
rritet e rritet e pushton hapësirat e mëdha të
mendimit,
rritet e rritet e pushton hapësirat e mëdha të së
vërtetës,
Parti, dyzetepesëvjeçarja ime, dyzetepesëshekullorja
ime!

• • •

Me duart e mia të çara nga puna e lufta, e jeta
të rrahura
gjithçka që më shërben transformoj,
krijoj gjithçka që kam ëndërruar të krijoj
dhe marshoj, dhe marshoj; marshoj
në orë, ditë, javë, muaj, vite e dekada.
Unë, zot i jetës që më rrrethon,
me bukurinë e punës shtoj bukurinë time
pa turp, pa hile, dëngla e pretendime.
Zot më bëre ti, Partia ime!

Krijoj fytyrën e ditës, të qeshur e të madhe si
imja
dhe ditë natën e verbër bëj,
krijoj fytyrën e njomë të fëmisë, e rris, e madhoj
që edhe ai si unë, i palodhur të krijojë...
Krijoj fytyrën e ujit që rrjedh kot, e shtrëngoj, e
rrotulloj;
udhën që dua, në turbina i jap. Dhe dritën zotëroj.
Oh, ç'fytyrë përrallore, e mahnitshme! Sa të kam
ëndërruar!
Sa gjatë! Sa gjatë!

Shënoj vendburimet e dritës në hartë: Vau i
Dejës, Koman, Banjë.
Dhe kur çelësin e dritës hap, urimi si drita
rrjedh për ty,
më i pastri nga gjithë urimet njerëzore, Parti!
Veç krahët kisha...
Ti më dhe krahët e shqipes, fluturimin e madh
veç ti ma dhe
dhe ngrita uzina e fabrika të panjohura ndonjëherë,
hidrocentrale, qytete,
ngrita vetveten mbi të gjitha, madhështinë përmbi
dhe,
shekullin në dorë veç ti ma dhe.

• • •

Jam në Bajram Curri me burrin e maleve në
zemër,
rroj si më mirë, në Kukës shkrij bakrin e kuq,
nxjerr krom,
ngre urat madhështore, qytetin e ri. Udhë i hap së
nesërmes,
në Shkodër holloj bakrin, u jap formë telave,
në Fierzë jam, i përvishem Drinit, shiritin e
përrurimit Komanit i pres,
Banjën përshëndes.
Me këto shpatulla, me këto duar digat gjer në re
i ngrita dhe i ngre.
Veç rritje kam ndiér nëpër provat e farkëtimit
tim —
mendimet e partishme mal më kanë ngritur dhe
më ngrenë.
Zotëroj lisat shekullorë me legjenda e kuje,
bukurinë kryelartë e bëj të jetojë me mua në
dhomë,
fushave të Myzeqesë rroj, mbledh gonxhen e
bardhë,
në pllajën e Hasit jam, mbjell luliedielli, misër,
grurë,
jam kudo, rroj kudo, në fshatra, qytete: në jugun
e kaltër e të gjelbër,

në veriun e bardhë. Në Tiranën e kuqe vij
ballëlart e faqendritur,
hyj serbes në Pallatin e Kongreseve, dal me
gjoksin mal,
me krahë të rinj i futem Shqipërisë,
prodhoj çeliqe, zgjas krahët e mi të hekurt në
Laç-Shkodër, Hani i Hotit,
Fier-Vlorë, Milot-Rrëshen-Klos; përqafoj pemën
e dritës,
ullirin e pavdekshëm
dhe e bëj të jetojë me moshën time rino...
I pranishëm kudo: si gjelbërimi, si lulja çel, krijoj
kudo,
djersij në të gjitha fushat e veprat: të bukës e
çelikut,
të bukurisë e dritës.
Dhe as nuk përkulem, as nuk jepem,
në shpatullat e mia mbështetem.

• • •

Jam guximi, sakrifica, qëndresa, krenari e së
djeshmes, të sotmes dhe të nesërmes,
Vasili jam, qëlloj mbretër e mbretëri.
Dhe mbi bllokadën ngrihem me përparimin tim
gjëmim.
Perlati jam, Brankoja, Jordani: përfshak e zharrit
gjithçka,

veç në buzë, në sy: ëndrrën e përjetshme-lirinë
me trupin tim ushqej, në vështrimin tim e mbaj.
Fjala ime e qartë, e drejtë dhe guximplotë, shihni:
është papërkulshmëri, guxim i të fortëve.
Jam Vojaja, me gjoks të zakonshëm si gjithë
 gjokset njerëzorë
që bën tanksin të heshtë.

E bëra dje, e bëj sot dhe nesër.

Jam Asimi me zërin e fuqishëm e krismë të
 tmerrshme.

Mund të bie një mijë herë në Mezhgoran
e prapë të ngrihem në këmbë
sijeta shqiptare ngrihet;

Mezhgoran bëj gjithë Shqipërinë: çdo gur, shkëmb
 e lis.

Përgjakem. Vë buzët në tokën time dhe për luftë
 të re rilind.

Jam i papërkulur si e ardhmjë.

(Ja, tani ne do të këndojojmë... Cilën?

«Malet me blerim mbuluar» që e lamë në mes
 para betejës, në agim.

E ndiej dorën tënde në timen, xha Zoi,
dhe rifillimin e këngës sonë himn...)

Qeribaja, Lihe Braha, Lica e imët
(s'kish kohë të pritje sa të rriteshe, Licë,
dhe u rrite kaq shumë sa askush s'është rritë...),
Kajoja-çelur në tokë e ajër si karafil për të gjithë.

...Jam unë në 28 mijë dhe ata tek unë janë,
gjaku i pastër, i ndershëm, sytë-horizonte m'i
dhanë, tek unë janë.

• • •

Unë jam dita, gëzimi, puna dhe bukuri e saj e
përjetshme,
ky mëngjes, dielli që puth dhenë... Me gjithë
forcë në jetë
të jetës urrej e dashuroj
dhe marshoj, dhe marshoj, dhe marshoj...
Si kjo faqe malit është balli i marshimit tim,
erë e mirë e Atdheut ia fshin djersët butësisht,
forcat tokë e të rënëve ia përtërin, mëngjeset
që vijnë.

Këshillë e hershme

Në një troshë buke mençuri e vuajtjes ha veten,
si në pikë gjaku sy i së ardhmes ngre jetën.

Ullinjtë e Vlorës

Ullinj të mocëm pranë shtëpive tonë,
në shpate,
sheshe,
bri honeve,
në shtatoren tuaj e gjelbërimin
Ismail Qemalin shoh e Boletimin...
Dhe përkulem si para dëshmorëve.

Flasim për botën e njeriut...

Mos më fol më për atë njeri të vogël! Ka kohë
e kam harruar krejt.

Nuk dua të dëgjoj!... Sidomos sot,
kur s'ka vend aspak për vogëlsira,
sot edhe njeriu më i zakonshëm shkon drejt heroit,
sot kur Fili¹⁾ s'është më dhe e shoh te të gjithë,
Fili me shtat mesatar, si unë e ti, esmer,
fjalëpakë,
shok i gjerë, baba i mirë,
statujë e bardhë kah mëngjeseve që vijnë...
Mund të flasim gjithë ditën për Filin, Dikun dhe
të tjerë,
për të shtatëqindët, shkrirës të bakrit, i shkrinë
orteqet e Shtiqnit,
për mjekët e pafjetur me pavionet në çantat e
shpinës,
vajzat e fabrikës së kromit, fshatarët e Vilës,

1) Fil Hoxha — Hero i Punës Socialiste.

edhe për fëmijët e qytetit që lehtësojnë bredhat
me dorë.

Të flas për nxënësit në Gjinaj, barinjtë, shokët e mi:
Metin e shëndetshëm që prin në malin e lartë
prej nga liqeni i ngrirë me pasqyrë të stërmadhe
ngjan,
për Ymerin plak kockëfortë dhe Ymerin e ri plot
humor,
Oson e qetë, Lirinë këmbëlehtë, për Flamurin si
një lis e Tefën trupatlet...
Për jetën vigane që s'e mund asnje borë, asnje
ortek.

Për fitimtarët të flas. Jo për atë njeri të vogël!
Kudo që të jetë.

Mjaft! Jam ngopur!

Gjer në grykë jam ngopur
me fjalët shumëngjyrëshe pa bukë,
me sytë picërrakë,
me lëvizjet e panatyrrshme,
fytyrën e prerë
e gishtërinjtë eshtakë,
me të dridhurit nervoz
me shkak e pa shkak,
me çdo gjë të tijën cinike,
më shumë me zemrën e zezë ngjitur pas brinjëve.
Edhe ti harroje krejt. Flasim për botën e njeriut
të thjeshtë
që kurrë nuk vdes...


Kukës, dimër 1985

Kulla e Lumes

Të dinë prej eshtrave të armiqve,
thotë një version kronike.

Jo!

Me gurë je, si çdo urë,
veç me gjak e lidha gurin me gur.



Para se tē ikësh...

Kur jam nē valë krijimi, ti lér vetëm imazhin
e ngrohtë dhe dil,
dil nē shoqërítë e tua, gëzohu, pi kafe,
zbavitu buzë ujérave, bisedo me zogjtë pér mua,
lodro me fëmijët mbi barin e ri a borën e ftohtë,
qeshu, mos u ndiqej e vëtmuar.
Unë ju kujtoj pas çdo flete tē shkruar,
kur gëzohem dhe kur vuaj.

Kur jam nē valë krijimi, shtëpia jonë është e
vogël pér ne tē dy, grua.

Veçanërisht pér ato orë që do tē vijnë nē shtëpinë
tonë,
ti zgjidhe fjälën, më tē mirën, para se tē ikësh,
afroma gushën, tē gastartën, para se tē ikësh,
afroma buzën, jetësoren, para se tē ikësh,
i duaj fëmijët më fort pér ato orë që do tē vijnë,
lulet freskoji, preki me dorë, para se tē ikësh,

dhomën e vetme me kujdesin tënd ndrite, para
se të ikësh,
se do të kem miqtë e zemrës nga malet e fushat,
heronj me plagë ende të pambyllura, lajme nga
luftërat.
Ma lër qiellin e syve të tu në dhomë, para se të
ikësh,
dhe unë do të jem me shpirt të lehtë, mikpritës,
dhe tokë, dhe qìell, dhe det...

P a t i t u l l

Gjoksin tim po ta çani,
si zemër troket mali.

Dik, i paharruari im!

Tungjatjeta, Dik! S'di përse e ngrita dorën papritur
të të përshëndes, miku im,
e ti askund rreth meje... Dora në ajër më ngriu.
Si ky kërcell me dimër kjo dorë në vetmi.
E ula dhe vara kokën në gjoksin e lëdhur,
mbylla sytë të të kujtoj ty. Prej bebëzave besnike
dole, Dik,
me gazin e shkujdesur, trupin e bëshëm e ballin
e lartë,
me duart e mëdha, të ashpra, të nxira
e në mes pëllëmbëve një leckë për të pastruar
vajrat.
Prapë ngrita dorën çliruar nga dimri e ngrica,
përshëndeta çdo pjesëz të peizazhit të ndryshuar.
Ishte te të gjitha.

Tungjatjeta,
udhë e pafund, ti ruan hapat e nxituar të Dikut,
fushë e gjérë,
që erdhe në jetë nga mundimi i duarve të ashpra,
pyllnajë,

që pret të bëhesh e plleshme nga guximi i Dikut,
burim i kaltër si sy i pastër,
ku shuan etjen në gjunjë dhe bërryla mbështetur,
lis i vetëm

merr pjesë në çlodhjen, qetëson drekën e shpejtë
në zheg, ju përshëndes;
dhe Dikun kam përshëndetur. Je kudo me kujdesin
e dhembshur.

— sy i pafjetur. Edhe pranë meje me
bashkudhëtarin e hekurt
që gulçon e hap gjoksin e dherave për pjellori
të re.

Ku ka tokë, ajër, lisa e gurë majëmprehtë bubullon
e qeshura

e natyrshme, biskon e nesërmja,
rrudhëset toka nga të thelluarat e ballit në ditë
të vështira

së kjo e sotmja. Me nderim para teje hapet bora
e udha merr frymë të kalojë buka, dashuria..
Në të gjitha gjërat je, Dik, i paharruari im, i
patundur si një mal

ku fryn, fryn një dimër i egër lokal.
Si për askënd kam fort nevojë për ty,
sypatremburi im,
këtë çast dobësie të bisedoj vetëm me ty, të qaj
hall,

nga sytë e tu zjarr, forcë të marr.

Meqë je larg, udhëve të zëna, në Has,
le të jetë kujtimi për ty kjo bisedë në mungësë,
ky peizazh, heshtja që flet, udhët që hap, kodrat
varg e varg,
ky veri që fryn, fryn, kjo lodër pa emër —
balli yt i mençur. Emrin tënd do t'i ve sot, në çast.
Emri yt meriton një mal.

Kukës, dimër 1985

*Kryelartë si malet,
të gjërë si deti...*

Pranë detit përvëlohem për malet,
me malet digjem për detin...
I dua njerëzit që kanë dhe njërin
dhe tjetrin.

Motrës në ditën e martesës

Ti po shkon në diell, motra ime... Mirë vafsh!

Për krahësh të mbajnë babai e vëllai.
E sëmurë nuk ndihesh... Prej ç'meraku tretesh
nga sytë e përlotur,
sorkadhe e plagosur?!...

Dhe ecke ngadalë, sikur shkel mbi yje,
e mira, motra ime!

A mos je prej qelqi e po thyhesh,
a mos je prej bore e po shkrihesh,
a mos je prej vese e po tretesh,
e shtrenjta, motra ime,
krahë dhe zemra zgjatëm ti të ecësh...

Tash nuk kam zili asnje flutur,
(Ah, të dija kaq të bukur!)

Ti po shkon në diell, motra ime... Mirë ardhsh!

Të lirë botën e duam

(Popujve në botë që luftojnë për të qenë të lirë e të pavarur)

p o e m ë

E kam ruajtur një këngë për ty, e dashura ime,
do ta këndoj të dielën.

(Mos ma kërko asnje ditë tjetër!)

S'i kujtoj dot as tingull as fjalë ditët e tjera,
as forcë s'kam ta këndoj para se të vijë e diela.

Të gjitha i kam të zëna. Që nga e hëna
gjer tek e shtuna me nxënësit jam në Gjinaj,
me blegtorë e gjeologë udhëtoj në male.

Pushoj në mbrëmje, njihem me përparimin e
vendit tim,

ndjek përpjekjet e proletarëve
që luftojnë me shpresë plot, udhën t'i hapin
këngës në botë.

(Edhe ti tani, ulur pranë fëmijëve,
shikon ditën tonë diellore
dhe ditën e përgjakur të botës në ekranin e vogël.)
Mbrëmja, domosdo, shqetësohet disa orë...

Ditën e re më shumë se atë që shkoi besoj,
në gjakun, në grushtet proletare të bashkuar:
Të lirë botën e duam!

Si pasqyrën e xhepit e kam me vete fytyrën tënde
të hijshme,
burim kurajo dhe drite, e dashura ime!

Të diel në mëngjes më prit te Ura e Madhe,
në të hyrë të qytetit pa trazira,
aty ku lumenjtë tanë qetësohen me liqenin,
ku ndihet aroma e bukës së pjekur, e mollëve
dhe fjalët e lira,
aty ku toka fal për të gjithë dashuri
dhe quell' i kaltër, (i kaltër si sytë e tu!)
e dielli i madh qetësish i rri përmbi.

Botën dashuri e duam!
Për quell' të kaltër luftojnë proletarët, e mira ime,
shih grushtet ngritur në Filipine, Haiti,
Salvador a diku tjetër...

Popujt në këmbë janë të gjithë!

E dua revoltën e ndezur. Mos u çudit!
Popujt i dua si popullin tim: në liri e paqe.
Dhe gjer atë ditë tek unë do të gjëmojnë shtetet,
kontinentet,

popujt ashtu siç janë; në përleshje
fytafyt me vdekjen.
Shikojji proletarët mirë: në sy kanë Azi,
Afrikë në fytyrë, Amerikë Latine në grushtet e
ngritur,
këngën botërore këndoijnë të bashkuar:
Botën të lumtur e duam!
Mos u befaso nga fytyra e zezë, (ç'rëndësi ka
ngjyra!)
shpërthejnë getot zezake me bljuzin e lirisë
dhe shpresën në buzë,
me tam-tame, Lumin e vrerit dhe poezi britmë
nga Lengston Hjuz.
Mos u trishto për trupin nëse i mungon diçka,
një këmbë a një krah,
në Liban, Namibi, Saharën Perëndimore a në
vend tjetër,
në fushëbeteja diku e lanë.
Mos vajto në qofshin të verbër. E di, do të
kujtosh Homerin patjetër,
gjëma e Trojës ia shteri sytë... Po këngës,
o, këngës s'kishin ç't'i bënин! Është e pakapshme
nga shpatat, topuzët, shpërthimet e plumbat;
nuk e mbysin dot luftërat.
As në kohën tonë kur superfuqitë
nga një Trojë sajognë çdo vit...

Tokën e popujve shih si e kanë bërë,
gjithë gropë të llahtarshme, djegur e përzhitur,
shkrumb e hi,
mundi njerëzor rënkon në plagët e saj. Dhe mbi
to plagë të tjera:

Presioni i zi me «Pershing 2», me «Kruiz» dhe
«SS-20»!

Vampirët veç djersë e gjak kërkojnë nga ky planet.
Dhe e zvogëlojnë përditë planetin tonë, e mira
ime.

(Mos më thuaj asgjë! Më lër të flas!
E dua si tokën time.)

Nga majë e malit brita. E gjithë urrejtjen
e shtrydha në këngë shprese.
(Se ka nevojë për këngën tonë.)
Një copë kaltërsi kërkon. Gjithkund veç tym i zi...
Qielli në ethe!
Toka në ethe!
Detrat në ethe!

Brita: «Tokë, qiell e det janë të njeriut!»
Pastaj prapë brita për ty dhe për hatër të
Ekzyperisë.

Në emër të lirisë e paqes
planeti ynë të mos jetë Nagasaki, Hiroshimë.

Vetém proletarët
planetit tonë do t'i kthejnë përmasat
dhe qetësinë.

Eshtë ora kur ti u afron bukën eëmbël të vegjelvë
e pak më vonë gjumin e qetë në shtratin e ngrohtë.
Ashtu në këmbë stepesh me bukën në duar
nga një sekuencë filmike e vështirë:
Qindra nëna e fëmijë të mjerë nga xhami i ftotë
të shikojnë ty.

Kërkon tu gjesh sytë e terur, mollëzat e
gishtërinje,
ku janë?

Ua lénurën mishin lotët e hidhur të fëmijëve
pa strehë,
rakitikë, jetimë, të braktisur në brigje lumenjsh,
harqe urash e shkretëtira,
në periferi qytetesh trembur e truar...
Ata vëç shtohen, si miza lisi shtohen, paçka
se mbledhi n ndihma
e shpallin ditë ndërkombëtare fëmijësh të mjerë,
të harruar.

Ç'bënë?
Ç'i bëri botës lëmosha, më thuaj?!
(E di, edhe ti vuani, kur sheh miliona njerëz
që u mohohet e drejta e pamohueshme për të
jetuar në liri e paqe.)

...O, sa gjëra kemi për të thënë!
Brenda gjoksit tonë është bota e tërë.

Të diel në mëngjes më prit tek Ura e Madhe,
në të hyrë të qytetit pa trazira,
vij nga punët e lodhshme, nga javë e rënduar
 me ngjarje.

Eja me një grusht dhë nga toka e qetë me farën
 e nesërme,

me një dorë qiell të kaltër nga qielli ynë i pastër,
me rreze drite në vështrim,
më thirr me emër, afroma fytyrën
se mund të jetë shfytyruar nga dramat

ndërkombe^{tare},

kur falëm kurajon dhe dritën.

Më gëzo me shkollat e çerdhet e reja, me lindjet
 e mbara,

me të mbjellat, korrjet e shirjet,
me përurimet e grafikët e prodhimit,
me çdo gjë njerëzore që u shtua e u shumua
 në mungesën time...

Pastaj kujdesu për mua,
vij i lodhur, i pluhurosur, i përbaltur.
(Afromi burimet e mia!)
Ti gjithmonë shikon thellë meje, e dashura ime,

Besoj edhe tani e ndien sikur në trup kam diçka
nga java me barrikada e luftëtarëve:
pika loti dhe përgjakje,
buzë të çara nga etja dhe vapa,
zë të trashur nga thirrjet e britmat, sikur kam
gjyntimin e tyre; më duhet ndihma,
supi yt i brishtë ku të mbështetem... të mbushem
me jetë.

E prapë zërin tim dhe veten ta jap,
të luftoj e të thërras
me popujt për liri e paqe: Të lirë botën e duam.

Në dhomën tonë ku hyn gjithë bota,
kënga botërore magjepsëse do të vijë,
patjetër,
plot liri dhe shpresë.

Dhe nëse unë vonohem pak nga punët e javës,
të diel në mëngjes, ajo jam vetë.

1986

Liria

Në lirishtën e besës sonë, në bukën me kripë,
nën qiellin me diell e shi. Në emrin e lashtë
biskon, liri —
emër i madh i njeriut

Duke iku prej njeriut

Je më i dëmshmi nga të gjithë burokratët, shoku im i klasës, shoku im i bankës...

Se je i ri
dhe kërkon të fitosh sa më shpejt rëndësinë
«babaxhane»
duke shkelur mbi mua, prodhuesit e bukës dhe
veten tënde.

Në sy
ta shoh lakminë e karriges më të fortë, rendjen
e hatashme
për të kapur lavdinë e burokratëve...
Kështu, duke iku prej njeriut nga ora në orë,
për tu kthyer do të jetë tepër vonë.

Gruaja që bëhet nënë

Mundimi gjer në lindjen e fëmijës
mollëzave vjen me prenka të bakërt,
trupit i sajon një dhembje vijëza-vijëza
si në mermerin e bardhë damarët.

Oh, si hapet dhembja trupit,
dalëngadalë, pa kuptuar!
Në zgjerimin e përmasave të gruas
përgatit shekujt për të jetuar.

Larg teje

Me kujtimin për ty fle, me fytyrën tënde në
bebëza zgjohëm,
me kujtimin për ty flas, larg teje me emrin tënd
«shok»,
ulem në tryezat e vetmuara, pi cigare, eci, mendoj,
u jap udhë ditëve
me punët e zakonshime... Dhe pres më të mirën,
më të shpejtë, më të lehtë që më sjell drejt
teje.

Të gjitha këto e të tjera
me kujtimin për ty që më fal një trishtim të
lehtë.

E kam brenda vetes, e prek, e shoh te të tjerë,
në zërin tënd të largët,
në timin dhe në zërat e posadëgjuar,
në duart që takoj, në urimet ai hyn
dhe unë jam mësuar.

Kjo do të thotë se të dua
për sa kohë do të kem në bebëza
ty dhe këtë trishtim të lehtë

që e kam unë e çdo gjë që shoh e prek...

Nga largësitë veriore të vije papritur në bregdet,
të gjitha do t'i bëja me ty. Saora
kujtimrishtimi im do të ikte në krahët e

Bulqizet
moderat

pulëbardhës së vëtmuar
e çdo gjë do të ishte si më parë, e zakonshme.
Tash e mbaj fort (as ai s'më le) se je ti ëndërr,
ky trishtim i lehtë që rri tek unë zgjuar
dhe mrekullon vizionin tënd të largët që ëndërron
për mua, grua.

Bukuri shqiptare

Harrohem para teje, bukuri e panjohur, vajzë e
hijshme,
burrë i shëndetshëm e i fuqishëm,
mjeshtri e duarve, e mendjes, kryevepër e natyrës,
më ndalon fryma, duart, këmbët, fjalët.

Para teje
s'di ku jam: te të vdekurit a te të gjallët...
Dhe gëzohem që kam sy të mahnitëm me ty,
bukuri.

Të fryjë juga!

Nxënësit erdhën me sandalet e verës
e trikot e pambukta të vjeshtës
dhe veriu fryn, fryn...

Nënët po mbarojnë trikot e leshta,
(e ndiej vrapin e shtizave)
gishtat therin nënët e mira.

Të fryjë juga, patjetër të fryjë!
Ndryshe veriut gjoksin do t'i vë pritë
të mos dridhen fëmijtë.

Elegji për bujkun Oso

Gëzimit i mungon një pjesë,
vuajtjes i qe shtuar diçka,
Udhës ngadalë më nuk ec
Osoja me këpucë të mëdha.

Në fytyrën pak të hequr —
sytë e qetë e të butë.
Era po grindet me gjethet
me emrin tënd në buzë.

Det i gjerë për njeriun
trazohej në trupin e paktë.
Veshur pantallonat e mira,
xhaketë kadife, të kaftë.

Oh, vuajtjes i qenka shtuar.
ajo që gëzimit i mungon.
Me emrin tënd në buzë
një lot mollëzën përvëlon.

Gjurmë të vogla

Ra borë...

Në sy
mëngjes i ri
m'u ngri.
E mora mëngjesin
e futa në gji.

(Dyqani i fshatit
a mori gjizme, pelice
për nxënësit e dashur?)

Gjithë natën ky shqetësim
dhe mëngjesi i bardhë
fjetën në gjirin tim.

Sot udhëza për shkollë
me gjurmë të vogla
në borë,

me viza viza e GD¹⁾,
GD e viza viza
më gëzoi
sa mençuri e fëmijëve.

1978

1) GD — Goma Durrës

Luan një orkestër

Luan një orkestër... Gjer vonë vjen muzikë
në dhomën e heshtur ku rrimë shtrirë
me sytë te fëmijët.

Ëndërrojmë sallën plot çifte të dashruar
dhe shpirti ndjell kujtime.

Sa është ora?... Kaq vonë të rrinë?!

Harrove se gjithë natën mund të vallëzonim
sy për sy

kur ishim të rinj?

S'është vonë,

një orkestër luan edhe në dhomën tonë...

Për fëmijët e mia

Për ju në çdo orë të natës vdes,
rilindém në çdo orë të ditës,
në qeshjen rritem, në vajin shkrihem
Dhe dridhem... dridhem
që ju të rriteni të qetë.

Busti i Shotës

Fundmarsi me pllangat e borës
ndryshoi diçka në bustin e Shotës.

Prej bronzit akull sytë e kuq i knin,
si pllanga gjaku prapa malesh binin.

Çdo kohë e ashpër, kryengritës
prej piedestaleve kërkoka ikje.

1981

Këngë trimërie

T'u vranë djemtë, bac-o! Haj medet!
Pa brisk në faqe more! Haj medet!

Iu territën sytë e thellë,
kryet iu rëndua pak.
Gjithë ajo zi, gjithë ajo peshë
tokë e qiell bënte hark.

Më e rëndë qe pesha tjetër
që s'e mban as qiell, as tokë.
Me të gjallët ai i vdekur
a i gjallë do të rrojë?!

Fol, haberxhi, në paç gojë!

Me mort e nder, bac-o, haj medet!
Udhët skuqën një me dhjetë...

Dritësuan sytë e thellë,
kryet ngriti gjer në re.
Gjithë ajo zi, gjithë ajo peshë
vallë ç'u bë, a nuk që?!

Coi haber për defatore,
coi haber për tupanxhi,
Dhe u ngrit mal me borë,
re trazonte me shami...

1981

Ec e thuaj!...

Ajo vajzë biskajë-gjallë e ëma: flokët, duart,
vështrimi dhe goja, shtati i saj, vetullat e buzët.
E qeshura mrekullon qytetin tim skaj më skaj.
Ec e thuaj vdekja e mori të ëmën pastaj...

N jë mërgimtar i

Ik nga udhët pa përshëndetje,
nga pallatet ku s'hapet asnje dritare pér ty
dhe asnje fytyrë e vetme s'të fal buzëqeshje!
Ik nga parqet më lule të akullta,
ik nga viset pa dashuri!
Gjithçka e huaj qenka aty.
Dhe fjala vret më shumë se çdo thikë.
Shpejto në brigjet e detit tënd,
mbi guackat e kujtimeve shtrije dorën,
në lartësitë e malit, që të pret e nga malli pér ty
 ka zgjatur kokën.
Shpejto në visin ku le dritën e syve,
ku gurë e drurë ndiejnë pér ty dhimbje
dhe trëndafilat mbeten në gonxhe gjer në
 mëngjesin e prekjes sate,
ku njerëzit ruajnë pér ty tokë pér varr e pér shtëpi,
në fushat e malet me diell ku zogj të rrinë mbi
 supe...

Toponime shqiptare

Në gjethë
pylli s'e lë veten,
nëpër letra
qysh ta linim jetën?!
Qenë të vogla,
nuk mjaftonin,
dhe me keq:
na tradhtonin.
Në tokën
që s'njeh tradhti
pa bërengë, humbje
mbyllëm sy...
Dhe toka
mori formën tonë;
me male,
butësira dhe kodra.
Ne ishim këtu:
mbi dhë
e nën dhë
kur formësohej botë

Jemi këtu:
mbi dhë
e nën dhë
Bëni zë!
Emrat në
i paçi harruar,
thirrni tokësoret mbishkrime
...dhe jemi zgjuar.

*Dy peizazhe nga Kukësi
i vjetër*

Ndarja

Heshtin udhët pa njeri,
piedestalet pa statuja;
rreth e qark edhe ajri
ngrirë pret të vijnë ujëra.

Edhe zogjtë paska tretur
me pak brengë nëpër sy.
I tmerron qytet i dhembshur,
kjo rrënojë me mërzi.

Kokëlart plepat vetëm
pëshpërisin thashetheme,
herë porsi prepotentët
ngrënë zërin kot prej ere.

Përmbi mua lamtumira
kaq rëndon, po bëj durim.
Këtu lindi, bëri dritë
yll' i mirë i zërit tim.

Lehtë shkel mos vrás udhët,
ëndrra, sy fëmijërie...
Mbi qytetin pa një frymë
pezull rríhka zemra ime.

Rishfaqja

Kur bie niveli i ujérave
qyteti rishfaqet, don të vijë pranë
si pleqtë e shpatave¹⁾) kur ngrihen në
këmbë.

Pa hapur gojë çmallemi ballë për ballë
si dy të përmallur kur s'gjejnë dot fjalë.

1) Valltarët pleq të Kukësit tek «Vallja e shpatave»

Një zog i vogël

Ka qenë një zog i vogël,
fluturonte në hapësirë,
po fole kish sytë e tu,
qiell-të mitë.

(Të kujtohet, dashuri?!)
Preknim gjoksin të dy,
i vinim veshin krahërорит
të ndienim fluturimin e zogut...

E në puthjen tonë buzënjomë
trupi i tij bëhej dritë
me sqep, pendë e cicërimë.

E na ngatërrrohej nëpër frymë,
buzë e sy,

krahëhapur ajo mrekulli
e vogël, e dashur...

(Të kujtohet, dashuri?!)

Kërkon nënën e detit

Kërkon nënën e detit, syeturi im,
dhe këmbëngul në çdo grua të bukur që kalon
pranë nesh
t'i prekësh ballin, supet,
se ajo patjetër qenka nëna e detit (!)
Po nëna e detit është toka, bir, më e vogël trefish
se i biri,
ai vazhdimisht e ha, e pakon e ajo prapë
e ka te gjiri...
Ti këmbëngul në çdo grua të bukur që kalon
pranë nesh,
përplas shputat në breg. Do përgjigje nga unë,
me hir a pahir.
— Toka dhe mëma jote janë nëna e detit, bir!...

Fëmijët e shkollës së fshatit

Në oborrin e shkollës heqin viza
me gurë a shkumës të bardhë.

Dhe pastaj... një rrasë
me një këmbë e shtyjnë me radhë.

Asgjë s'kërkojnë pér lodrën e tyre
fëmijët e shkollës sime.

Kështu para fillimit të mësimit,
kështu në pushimin e gjatë...

Gëzim fëmijës iu bëkan
edhe pak viza të drejta dhe një rrasë.

E pushtetshme u riktheve, poezi!

Kaq kohë pa ty... si të kisha humbur fëmijët!
Shëndetin e mirë humbisja pak nga pak, fitoja
harresë,
grindje me ndonjë burokrat
dhe prisja gjoksin të ma mbushje me gulçe drite
për fjalën që ende s'u tha,
botës t'i japim atë që ende s'e ka.
Të prisja ty që fisnikëron gjithçka...
Dhimbja e mosardhjes në qetësinë e natës
mungesën tënde lotonte vazhdimisht. (Kishe
humbur, shpirt!)
Mungoje, mungoje... Prisja kot...
...Udhët mora. Prej mallit u përvëlova. Deti m'u
bë shok, dallgët e fushat njoha,
të panjohur, miqtë e mi të rinj, heronj të shpallur
e të pashpallur që mbajnë fjalën e dhënë. Përqafova
tërë Shqipërinë
dhe ndjeva të lëvizje thellë në gjoksin tim.
Erdhën malet, rikthyen fëmijët,
të dashurit që s'pata kohë t'i doja,
mijëra të tjerë mbuluar nga mosnjohja,
erdhi rinia që donin të ma plaknin,
koha që donin të ma vidhni.
E pushtetshme u riktheve kur u mbusha me njeri,
poezi,
ti që vdes ku ka burokraci.

Varri i luftëtarit shqiptar larg atdheut

Si shpirtin ta besuam varrin, motër e largët,
për kujdesin e dorës dhe pikën e lotit që butëson
dheun e vdekjes,

t'i thamë të gjitha fjalët e zemrës,
mollë në gji shkrumbin e mallit të dhamë:
shi të butë t'ia pikëlosh mbi shtat,
bar të ri t'ia harbosh nëpër krahe
e dorën tënde t'ia lulosh mbi krye...

Në gjakun tonë u shkrite e na fjeti zemra,
motër e largët,

e së gjalli u ndamë me tokëdhimbje...

...Mes varreve të huaja qenke ngatërruar!

(O, mos fol! E mora vesh. Porosinë as dheu s'e tret.)

E fjalë në erë më flet tash sa vjet

për kujdes me atë dorë, motër moj!

Qysh s'ia njeh varrin shqiptarit?! Më i gjeri, më i
gjati,

me një lis që i bën hije shtatë bojë njeriu mbi krye,
ballë çdo stuhie...

Kryevepra

Gdhendën skulptorët perëndi
në ar, argjend edhe mermer.
Po shtatorja jote, njeri,
shkëlqente në majëqytet.

Arti me çekiç e daltë
forçën muskujve u shteri.
Mbi flokë, pluhur të bardhë
viteve hodhi mermeri...

Mu në mes të Akropolit
u ulën dhe pushuan pak.
Vezullimi i mrekullonte,
po diç donin të ndreqnin prapë!

Tjetër art kërkonin, tjetër,
dhe rëmonin thellë vetes.
Me të përditshmen e jetës
të krijonin kryeveprën.

E ashtu ~~si~~ qenë, të lodhur,
rrëmbyen daltat skulptorët.
Kur arti i tyre qe përsosur
nisën të gdhendnin shërbëtorët...

1975

12

S t r e h a

Sa herë largohem malli për ty ma shkoq kraharorin
me fytyrën kah shpina ime që largohet e largohet...

Dua të kthehem pa e zënë cakun e dëshirës,
drejt teje të vij, strehë!

Por e di, ti mrrolesh, mjegullat hyjnë midis nesh.

Dhe ec

për në cakun e punëve tona pafund.

Atëhere ti zgjat duart

që ndarje të mos ketë;

në njërin pak tokë, bukë të bardhë në tjetrin
dhe sa po humbas në horizont ma nis qiellin...

Dhe s'je më e vogla me trosha gjëzimi e halle,

Atdheu je, me detra, lumenj, njerëz, fusha e male.

Në shumë toka mund të shkel,

të fluturoj në shumë qiej,

tjetër bukë mund të ha, të tjera kafe të pi.

Te gurët e tu do të kthehem:

në tokën ku kam themel, nën qiellin me zogjtë e mi,
në bukën e bardhë e kafen tënde të zezë, shtëpi!

... Dhe emrin e ka Arbër

Ku ka dy lastarë të blertë harkuar në përqafim,
dhjetë zogj të pushtë që tek unë cicërijnë,
është fëmija im.

Ku ka dy sy të mrekullueshëm që pikojnë dritë
mbi njerëz e dhë pemë e milingona,
ndrit dielli im.

Ku ka dy gonxhe që me zor hapen e dridhshëm
përflaken
kur burrërisht kërkojnë fjalët,
plas karafili im.

Ku ka kokërrza orizi që sapo nisin të shfaqen
falin lulen e gojës në pëllëmbë të dorës,
gufon gjaku im.

Ku ka një tē qarë fëmije, tejpërtej ma shpon
zemrën
dhe ditën ma mbush me hidhërim,
dhemb malli im.

Ku ka një tē qeshur gjer në mpakje që gjelbëron
barin,
rrit njeriun dhe pemët plas në lulim,
qesh ylli im.

... Dhe emrin e ka Arbër.

Me ju, në sheshin e luftës

Kur me cinizëm t'ju thonë disa: «S'ka më frymë,
ka vdekur!»

Mos besoni! Nuk kam heshtur!

Ata janë mediokrit, të prapambeturit
që koha i veçoi nga të tjerët... Dhe tërë jetën
më fort se mençurinë e tyre
heshtjen time deshën.

Me ju jam të gjitha orët: me mësuesit e fshatit,
nxënësit e minatorët,
me punëtorët e mirëmbajtjes-rruga, fshatarët,
metalurgët,

(Me ju pérherë gjëmim e paskam gojën!)
me hallet tuaja, në sheshin e luftës, përsosmërisht
i bukur
mbuluar me vallet e Lumës...

Të jetosh me ty

poemë

I.

Me këta sy të pashë kur terr e myk gropose
 shtatë pash nën dhë
në emër të ajrit që lirshëm thithim,
në emër të mrekullisë që prej mëngjesit lindte,
në emër të frëngjisë që u bë dritare,
në emër të pikës së gjakut që u bë lule;
në emër të trupit të lakuriqtë që i falet dritës,
në emër të përqafimit me lirinë,
në emër të ndrydhjes që u bë guxim,
në emër të gjoksit grusht që u bë hapësirë,
në emër të heshtjes varr që u bë fjalë e lirë.
(Sa të kam pritur!
Veç ashti e din, lumi im, edhe sytë...)
Pasha dritën e syve:
jetën mbolle në emrin tim!

2.

Në zemër të maleve me diell e kam shtëpinë
dhe emrin e ka Lumë
dhe emrin e ka Has
shtëpia ime me gurë
e rrënëjë në gjak.

Këtu më kërkoni, shokë e miq,
me djep e varr!

Mes për mes oborrit shkon lumi im i bardhë
e në qofshi të zënë kur malli t'ju marrë,
m'i çoni me Drinin e Bardhë ato fjalë...
(Fjalët e mia me zogjtë e verës ua çoj,
me erën e gjethit të ri...)

Shtëpinë ti ma mbushe inë ajër e kaltërsi
(Edhe gurët po e ndjekan rritën tonë
e po u rritkan,
lulen në zemër e harliskan!)

Portat dritës i hape krah e krah
e dritare qiellore çelë në trupin tim,
 në sytë e mi,

filizat e djegur në terr i nise kah dielli
e toka rrëth e rrëth shtëpisë
saora prushiti sytha të rinj
 si yj

e lëshoi shtat kjo mrekulli,
• kur ditës i the: çel, çel pa frikë,
unë erdha për ty, bukuri!

Ishte dora jote që farën e re hidhte,

Parti!

3.

S'kisha ngé tē dashuroja.

Nëpër terr i ngjizja fëmijët. Dhe vrapoja në pritë
(Oh, vrisja «hasmin».

Jo, trupin tim me pamje tjetër...)

Sa armiqtë tanë e urreja terrin, terrin, e dashura
ime!

Edhe kur prekja shtatin tënd tē ngrohtë,
një dorë dritë (sa e desha!), e desha nga perdja e
hollë e dhomës pér flokët,
gonxhen e plasur tē buzëve dhe gushën,
një dorë dritë (sa e desha!) nga vrima e derës pér
dehjen,
gjoksin borë dhe përkëdheljen. E urreja terrin,
çdo minutë errësirë!...

Nga netët verore dhe netët dimërore një dorë
dritë (sa e desha!)

e desha

në emër tē njeriut.

Netëve pa hënë e borë, tē errëta tmerrësisht,
çmund t'i kërkonim tokës,
qiellit çmund t'i kërkonim?!

Dritësonim njëri-tjetrin
me gishta e buzë,
për inat të territ:
ishe ti Toka, Dielli-unë.

Herë herë s'arrija as t'i shpërvjel mëngët e zëna
të hynte dielli,
të hynte hëna.

Fërgëllloja. Nuk gjeja qetësi.

Në odën errësirë
të falja një puthje të shpejtë.
(Ishe kaq e brishtë, më vraftë ora,
e unë i butë si prekje dashurie,
levore ahu ftyra ime.)

Dhe vrapoja
në mbledhjen e Dheut të lidhja besën
nga hyrja e vjeshtës gjer në majin e zi,
sa mbaronim një luftë,
tjetër nisnim përsëri...

4. ,

..Nëpër luftëra e këngë
veten kam ngrënë
dhe u pakova kështu
si e reja hënë.
Edhe lumi, besnik si hija,

u thinj

prej vuajtjes sime...

Kur terrin më s'e pashë
e zambak i dritës u hap,
zërin tënd ndjeva mirë:
thirre njerinë.

(Dhe brenda meje diçka
bëri «krak!»)

Po thyhej vëtmia,
kockat e zotave
a çelës i dritës u hap?!

Më thirre nga britmat e territ të ikja,
drejt mirësisë e dritës të vija...

Parti!

5.

Të gjitha kishin ndodhur, o shpresë!

U hap qëlli i syve të kthjellët pa asnjë re,
lumi i gjakut të pastër thërriste me zëra drite,
ndjeva të zgjoheshin varret e martirëve,
të hapeshin buzët e fëmijëve,
plotësinë e gjithçkaje që ëndërron njeriu,
gjerësinë e mirësinë,
yllësinë ndjeva të ulej përmbi dhë,
emrin tim nga errësira
të, ngjitej në vend të yjeve.
Të ndjeva ty si ajrin, si emrin,
të ndjeva ty si lumin tim besnik.

Po lindte njeriu...

Hapa krahët si fëmijë
e u harrova me ty...

6.

Sa bukur qenka me ty,
faqe për faqe, sy për sy!
Sa bukur qenka me ty,
pëllëmbë në pëllëmbë,
dashuri në dashuri!
Ndritka gjithçka,
luloka vetëjeta
si lulon trupi nga zemra!
Edhe ëndrra paska sy
e u bëka kaq e prekshme,
si njeri e përkëdhelke!
Edhe plaga çelka lule
e u bëka krejt e kuqe!
Edhe lodhja u harroka,
pranë teje u qetësoka,
u mbështetka, merrka forca
e u rritka, u madhoka,
jetën gjithë përqafoka!

7.

Me ty dhembjen ndaj si mollën. Dhe gëzimin
gjithashtu,
veç te ti mora forcën, guxim vec nga sytë e tu!

Mijëra dashuri tek unë buisin
e më lidhin me ty si shtëpia me tokën, si toka
me rrënjet, me lisin:

te ti marrin ngrohtësi
e bëhen diej të vegjël në trupin tim,
si gjaku që bëhet farë e lirisë.

Urrejtjet e tmerrshme të armiqve tanë na lidhin
më fort.

Dhe luftojmë
kundër dëshirës së ethshme që mundohet të na
ndajë

(... e të ma shterë atë lumëbardhë,
... e të m'i shembë ato gurë strallë,
... e të m'i likë sytë në ballë!)

8.

Besnik zërit tënd me gjithë zërat e jetës,
besnik i vështrimit me qiellin e së sotmes dhe
së nesërmes,
besnik i dritareve që tek unë çelen krah e krah,

besnik i hapësirave që hape në tokë e në qiel
lart,
besnik i pikës së gjakut dhe të lotit;
jetoj me ty,
besnik i lumëbardhit tim plot e përplot,
besnik i gurëve të mi shtrënguar gjoks më gjoks,
jetoj me ty.

Ne të dy bërë një,
më njerëzorja dashuri dhe e shkruar mbi çdo gjë:
Të jetosh me ty!

9.

Çfarë s'bënë të mos vija drejt teje,
armiqtë e tu,
armiqtë e mi!
Si urithi gërmuan territ nga erdhën,
kërkuan shtatë pashë nën dhë
të gjenin një krimb, sido që të ishte,
nëpër trungun e lisit tim veç të ndodhej,
në degë, qoftë edhe në fletë.

Edhe nëse nuk mund të brente më,
këtë mirësi do ta bënин ata —
njerëzit e territ me nofulla të mëdha.
Akullnaja pastaj të shtrihej në shpirt,
gjer në palcë të ndieja vetminë,
nga kockat e thyera, plehu e hiri
përgjakjen si pluhurin e udhës të fshija.

Dhe t'i rikrijoja žotat shpejt,
zotat që me forcë i mohova.
E të dridhesha në terr e hiç,
në vend të gjakut të lëvrinte frikë.
Dritaret t'i bëja frëngji prapë
e lumëbardhi im të mbetej shtatthatë,
guximin ta shkëmbeja me ndrydhjen,
me lotin e hidhur gëzimin,
me terrin kaltërsinë,
me heshtjen varr fjalën e lirë,
në rrënë t'i thaja trëndafilat e mi,
gri të ish çdo gjë në sy,
stinët e lulet e qielli përmbi,
mendimet e buka e njerëzit gri...
Të dergjesha në terr e kllapi,
kokën të thyeja më gurët e mi...
Çfarë s'bënë për këtë «mirësi» (!)
armiqtë e tu,
armiqtë e mi!

Nëpër gjakun tim rridh, o lumëbardhë!
Mbi kockat e mia rritu, moj shtëpi!
Dritën kam kundër territ, pasha ty!

10.

Edhe në pyllnajë thashëthemesh
e në shkretëtirën e heshtjes,

edhe në errësirën më të thellë, të pashë ty
e më dhe jetë...

Në duart e mia të ndjeva, në damarë,
në orët e punës, mbasditeve e mbrëmjeve,
në gazin më pafre e dhimbjen më të idhët,
udhëve ku shkela dhe atyre ku do të shkel,
në lodhjen e çlodhjen
pranë teje mbështeta kokën,
u qetësova, mora forcën
e më dhe jetë...

Në bukën mbi tryezë, edhe në lulen e gurëve
të shtëpisë

ngrohte emri yt.

Me thërrmijën e dheut e rrezet e diellit
më lidhte emri yt.

Dhe shtëpia ime bëhej dyfish më e madhe,
më e fortë shumë herë, e pathyeshme — kështjellë
(Ti më dhe jetë).

Dhe shpesh besoja se ajo isha unë —

kockat e mia ato gurë...

Gjithçka më lidh me ty:

edhe stërkala e ujit, simetria e udhëve, sheshet
e qytetit tim verior,

e dashura muzikë e shiut

dhe përshëndetja e njeriut.

Edhe shpata e barit e sythi i ri,

një refren i njohur në buzë,

balta e përditshme, mrekullitë e tokës,
gruri i së ardhmes dhe kënga e zogut,
humbjet e vogla dhe fitorja.
Tek unë jetojnë malet me diell
dhe bëhem më i fortë, më i mirë;
se jetoj me ty.
Dhe lulëzoj...

II.

Në emër të madhështisë së mendimit dhe fjalës së
lirë pohoj e mohoj,
në emër të ecjes që më bëri të njoh vetveten,
në emër të kthjelltësisë së qiellit dhe syve ku
ëndërroj,
në emër të gjerësisë së zemrës dhe shpirtit ku
dashuroj,
në emër të mrekullisë së gjakut dhe buzëve ku
rilindem.
në emër të shenjtërisë së tokës dhe pragut ku
rritem,
në emër të gjoksit borë e thithit të argjendtë ku
piva të vërtetën,
në emër të lumëbardhit tim besnik përtej vdekjes,
në emër të së sotmes dhe të nesërmes,
në emër të gjakut të martirëve dhe lotit të fëmijëve,
në emër të shtëpisë sime Lumëhas,

në emër të njeriut të ri që rriti Partia ime
guxoj të pështyj, të shkel, të gropos gjithë
ndyrësitë, të vjetra dhe të reja,
guxoj të përqafoj tokë e qiell që janë të mitë,
unë — e sotmja dhe e nesërmja, bukuri e njeriut,
hapësirë pa anë, tokë-qiell shtati im i madh,
guxoj të ngjiz shtatore më të bukura se shtatorja
ime
në emër të njeriut.
Dhe jetoj me ty, Partia ime.

1983

P E R M B A J T J E

Këtu	3
Katunde të moçme veriore	5
Mëngjeset që vijnë unë i kam... (poemë)	7
Këshillë e hershme	13
Ullinitjë e Vlorës	15
Flasim për botën e njeriut..	16
Kulla e Lumës	18
Para se të ikësh...	19
Pa titull	21
Dik, i paharruari im!	22
Kryelartë si malet, të gjerë si deti..	24
Motrës në ditën e martesës	25
Të lirë botën e duam (poemë)	26
Liria	33
Duke ikur prej njeriut	35
Gruaja që bëhet nënë	36
Larg teje	37
Bukuri shqiptare	39
Të fryjë juga!	40
Elegji për bujkun Oso	41
Gjurmë të vogla	42
Luan një orkestër	44
Për fëmijët e mi	45
Busti i Shotës	46

Këngë trimërie	47
Ec e' thuaj!...	49
Një mërgimtari	50
Toponime shqiptare	51
Dy peisazhe nga Kukësi i vjetër	56
Një zog i vogël...	55
Kërkon nënën e detit	56
Fëmijë e shkollës së fshatit	57
E pushtetshme u riktheve, poezi!	58
Varri i luftëtarit shqiptar larg atdheut	59
Kryevepra	60
Streha	62
.. Dhe emrin e ka Arbër	63
Me ju, në sheshin e luftës	65
Të jetosh me ty" (poemë)	66

Spahiu, A.

Të jetosh me ty. Vjersha dhe poema.
[Red.: S. Dajol T., «Naim Frashëri», 1987.]

80 f

(B. m.) dhe

(B. v.): 891.983-1

S 81

Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/16

Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1987